



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 959/

Tirane, date 09.11.2015

Drejtuar: Z.DHIMITER KAPAJ
SHOQERIA "D.K.S GROUP" SH.P.K
RRAJONI 5, LAGJIA KUSHTRIMI

VLORE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1437 date 16.09.2009.

I nderuar z. Kapaj,

Shoqëria "D.K.S Group" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1437 date 16.09.2009, për ranore pllakore, Skrapar, ne Qarkun Berat.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2046 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.959 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1437 date 16.09.2009, për ranore pllakore, Skrapar, ne Qarkun Berat, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin për vitin 2013-2014 dhe për vitin 2014 - 2015.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjuhën "ç" të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të leje minerare të shfrytëzimit nr.1437 datë 16.09.2009, për ranore pllakore, Skrapar, në Qarkun Berat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1437 datë 16.09.2009.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNORI

